



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/29/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga A.H ndaj gjyqtarit E.G, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë: 11.12.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ushtruar nga A.H ndaj gjyqtarit E.G për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës A.H me datë 18.11.2024 në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit E.G, me pretendimet për shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 të Ligjit për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sipas kompetencës, ankesa është përcjellë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 25.11.2024.

Parashtruesi i ankesës në ankesën e tij ka deklaruar se gjyqtari E.G, ka kryer shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 par 2, pika 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.8 të Ligjit 06/L-057, gjatë trajtimit të lëndës ku i njëjti është në cilësinë e palës së akuzuar, ndërsa në cilësinë e palës së dëmtuar është D.A, ish bashkëshortja e tij. Sipas tij, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.11.2024 në ora 13:30, e cila po mbahej në Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjyqtari i çështjes E.G ka pasur sjellje të pahijshme së bashku me palën e dëmtuar. Po ashtu tutje i njëjti pretendon se gjyqtari i çështjes E.G dhe e dëmtuara D.A, ishin shoqëruar së bashku dhe sipas tij i kishte parë më datë 10.11.2024.

Në lidhje me ankesën e parashtruar, gjyqtari i çështjes përmes deklaratës së datës 02.12.2024 adresuar Kryetares së Gjykatës, ka deklaruar se parashtruesi i ankesës në rastin konkret është i akuzuar për shkak të veprës penale “Kanosje” nga neni 181 par.4 lidhur me par.1, dhe par.2, lidhur me nenit 248 të KPRK-së dhe lënda është në procedurë te gjyqtari i çështjes sipas shpërndarjes së lëndës. I njëjti ka deklaruar se si gjyqtar i kësaj gjykate pasi që ka pranuar lëndën, ka ndërmarre veprime procedurale, ashtu që ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.02.2023, në të cilën nuk kishin prezantuar, as i pandehuri as e dëmtuara. Gjyqtari tutje deklaron se gjykata ka vazhduar duke ndërmarrë veprimet procedurale për të sjellë në

seancë të akuzuarin A.H , ashtu që ndaj të njëjtit me datë 16.05.2024 ka lëshuar urdhër arrest, në seancën e datës: 04.06.2024 kishte prezantuar i akuzuari A.H , mirëpo nuk kishte prezantuar i akuzuari tjetër V.H, andaj seanca ishte shtyrë për datë: 06.09.2024, në të cilën seancë i akuzuari V.H, kishte pranuar fajësinë ndërsa i akuzuari A.H nuk kishte pranuar fajësinë për veprën për të cilën akuzohet. Gjyqtari tutje ka deklaruar se caktimi i seancës se shqyrtimit gjyqësor, kishte vazhduar në mënyre procedurale deri me datë 03.12.2024, e cila ishte shtyrë për këtë datë me kërkesë të mbrojtësit, pasi që në seancën e datës 04.11.2024 ishte dhënë fjala hyrëse e palëve.

Gjyqtari në deklarimin e tij lidhur me pretendimet ankimore të akuzuarit, ka theksuar se në seancën e datës 03.12.2024 i kishte paralajmëruar palët që fjalën përfundimtare mund të paraqesin në formë të shkruar dhe asnjëherë nuk kishte bërë asnjë veprim siç pretendohet në ankesën e të akuzuarit A.H , po ashtu i njëjti deklaroi se asnjë palë në procedure nuk i njeh dhe nuk ishte takuar në asnjë mënyrë me asnjërin prej tyre, për këtë nuk ka as prova të paraqitura në ankesë, si dhe i njëjti ka theksuar se i akuzuari me veprimet e tilla po mundohet të prolongoj procedurën penale.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoriteti Kompetent ka konstatuar se:

- ankesa disiplinore është e pabazuar.

Nuk është kontestuese se gjyqtari E.G është i ngarkuar me lëndën në fjalë, në të cilën parashtruesi i ankesës A.H , është në cilësinë e palës së akuzuar, për veprën penale “Kanosje” nga neni 181 par.4 lidhur me par.1 dhe par.2, lidhur me nenin 248 të KPRK-së, ndërsa palë e dëmtuar është D.A, bashkëshortja e të akuzuarit.

Pretendimet e ngritura në ankesë janë të përgjithshme dhe të pambështetura në prova bindëse, të cilat do të mund të vërtetonin shkeljet disiplinore të pretenduara sipas nenit 5 të Ligjit për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Sjelljet e pretenduara si të papërshtatshme nga gjyqtari E.G gjatë seancës gjyqësore të datës 04.11.2024 nuk janë të dokumentuara në mënyrë që të përbëjnë bazë për inicim të procedurës disiplinore. Pretendimet për sjellje të pahijshme a po të përshtatshme të gjyqtarit gjatë trajtimit të një lënde gjyqësore duhet të jenë të konstatuara në procesverbalin gjyqësor, në mënyrë që të njëjtat të jenë bazë për procedura të mëtutjeshme.

Po ashtu, i paprovuar dhe i pa dokumentuar ka mbetur edhe pretendimi se gjyqtari dhe pala e dëmtuar janë parë të shoqëruar me datë 10.11.2024.

Vetëm deklarimi i parashtruesit të ankesës se ka ndodhur një ngjarje e tillë nuk mund të konsiderohet si bazë e mjaftueshme për të mbështetur një pretendim. Në parimin e së drejtës, faktet duhet të provohen përmes mjeteve të lejueshme ligjore, si dokumente a po prova të tjera materiale.

Procedurat disiplinore duhet të jenë të bazuara në fakte dhe prova, andaj ngritja e procedurave disiplinore pa prova të mjaftueshme do të cenonte jo vetëm integritetin personal të gjyqtarit të ankimuar, por edhe sigurinë ligjore të sistemit gjyqësor. Ndërsa, përpjekjet për të zvarritur çështjen cenojnë të drejtën e palës për një gjykim të drejtë dhe të shpejtë, në përputhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/29/24, me datë 11.12.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë